



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM

Nr. 14 Datë 25/04/2023

**“PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE DHE MIRATIMIN E
REGJISTRIT TË PROKURIMEVE, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE,
PËR VITIN KALENDARIK 2023”.**

Në zbatim të Nenit 3, Pika 3 dhe Nenit 49 e vijim ...të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Administrimit, pasi shqyrtoi materialin dhe Vendimin Nr.20, datë 18/04/2023, dërguar nga Senati Akademik si dhe relacionin e paraqitur nga Administratorja e Universitetit të Arteve, Znj. Alma Sinanaj për “Shpërndarjen e të ardhurave dhe regjistrin e prokurimeve”, pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpërndarjes së të ardhurave , për vitin kalendarik 2023, në Universitetin e Arteve, sipas tabelës Nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Miratimin e regjistrit të prokurimeve për vitin kalendarik 2023, në Universitetin e Arteve, sipas tabelës Nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare dhe të dërgohet në Ministri të Arsimit dhe Sportit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Lavdrim SAHITAJ (Kryetar)

Ergis SEFA (Anëtar)

Prof. Asoc. Dr. Sokol SARAÇI (Anëtar)

Prof. Besnik BISHA (Anëtar)

Jeton SHEHU (Anëtar)

Lorenc VANGJELI (Anëtar)

Vladimir LLAKAJ (Anëtar)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
ADMINISTRATOR

Nr. 387 prot.

Tiranë, më 12/04/2022

Propozim për shpërndarjen e të ardhurave dhe regjistrin e prokurimit për vitin 2023


Senatit Akademik të Universitetit të Arteve

Universiteti i Arteve, për vitin 2023, ka parashikuar të realizojë të ardhurat me vlerë 43.908.689 lek. Sjellim ne vemendje se, të ardhurat e realizuara për vitin 2022 nga UART, kanë qenë 39.351.031 lek.

Burimet e krijimit të të ardhurave, për vitin 2023, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Burimet e krijimit	Vlera (lek)
1	Tarifë shkollimi	37,080,285
2	Tarifë konkurrimi & regjistrimi	2,256,730
3	Shërbim salle	2,000,000
4	Qira ambjente	2,364,804
5	Diploma, vërtet., shtypshk etj	300,000
TOTALI		44,001,819

Në vijim do të paraqesim shpjegimet për zërat e tabelës së mësipërme:

- Zëri “Tarifa shkollimi” – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga tarifat e shkollimit përcaktuar në vendimet përkatëse (VBA Nr.3 datë 04.04.2022 dhe VSA Nr.18 datë 10.03.2022) për këtë qëllim. Parashikimi i këtyre të ardhura është bazuar në numrin e studentëve, të cilët janë regjistruar dhe do të paguajnë tarifën e shkollimit për vitin akademik 2022-2023, numër i cili është 791 studentë, nga të cilët 472 studentë të regjistruar në Ciklin e Parë dhe vlera e parashikuar të arketohet do të jetë 13.122.000 lek dhe 319 studentë në ciklin e dytë dhe vlera e parashikuar të arketohet do të jetë 23.958.285 lek.
- Zëri “Tarifë konkurrimi & regjistrimi” – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat, që sipas vendimeve të organeve drejtuese të UART (VBA Nr.3 datë 04.04.2022 dhe VSA Nr.18 datë 10.03.2022), për këtë qëllim, parashikohen të realizohen nga konkurset e pranimit dhe tarifat e regjistrimit, të cilët realizohen për aplikantët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në UART.
- Zëri “Shërbim salle” – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga kontratat e shërbimit (“Black Box”, ”Cesk Zadeja”, “Galeria e FAB”) 




REPUBLIKA E SHQIPËRIË

subjekteve private dhe shtetërore. Në planifikimin e këtij zëri jemi bazuar duke marrë në konsideratë që Salla e Madhe do të fillojë funksionimin në muajin Maj 2023, mbas rikonstruktimit të saj..

- Zëri “Qira ambjente” – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga dhënia me qera e ambjeteve të UART. Në planifikimin e këtij zëri jemi bazuar në 3 kontrata që janë për dhënien me qera të ambjeteve të UART.
- Zëri “Diploma, vërtetime, shtypshkrime etj” – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga tarifat që aplikohen për marrjen e diplomave, nga ana e studentëve, vërtetimet e ndryshme. Parashikimi është bazuar në realizimin e vitit 2022.

Në grafikun e mëposhtëm, është paraqitur pesha specifike që zë cdo burim në krijimin e të ardhurave, në raport me të ardhurat totale, që parashikohen të realizohen për vitin 2023.



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të ardhurat e realizuara në vitin 2021 dhe 2022, krahasuar me ato të parashikuara të realizohen për vitin 2023.

Nr.	Burimi i krijimit i të ardhurave	Viti 2021 Realizim (Lek)	Viti 2022 Realizim (Lek)	Viti 2023 Parashikim (Lek)
1	Tarifë Shkollimi	33,367,830	33,221,810	37,080,285
2	Tarife konkurrimi & rregjistrimi	2,163,684	2,256,730	2,256,730
3	Shërbim salle	425,000	555,000	2,000,000
4	Qira ambjente	1,943,251	2,859,658	2,364,804
5	Diploma, vërtet., shtypshk etj	279,100	457,833	300,000
	TOTALI	38,178,865	39,351,031	44,001,819



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Me VBA Nr.3 datë 16.02.2023, u vendos bashkëfinancimi nga të ardhurat e vitit 2023, me vlerë 8.327.229 lek (Llog. 231), i projekteve (investimeve) për kërkimin shkencor në UART.

Me VBA Nr.5 date 16.02.2023, u vendos financimi nga të ardhurat e vitit 2023, me vlerë 1.018.454 lek (Llog.602), për vendosjen e pikës së lidhjes për kabinën e re elektrike të Sallës së Madhe.

Referuar sa me sipër, propozojmë që, të ardhurat e parashikuara të realizohen për vitin 2023, te cilave nuk u është percaktuar destinacioni, të shpërndahen si në tabelën e mëposhtme.

Nr. llog.	Emertimi	Vlera (Lek)
231	Investime	2,030,000
600	Paga	23,206,819
601	Sigurime shoq & shëndet.	3,640,766
602	Mallra & shërbime	3,358,940
	Fond i pashpërndarë	2,419,519
	TOTALI	34,656,044

Në vijim paraqiten shpjegimet për zërat e tabelës së mësipërme:

1. **Investime** – në këtë zë janë përfshirë:

- Blerje libra për shtimin e fondit të Bibliotekës së UART
- Pajisje (kompjuter, printer, programme dhe të ngjashme) për ngritjen e Labotatorit të CAD/CAM në Departamentin e Tekstilit dhe Modës pranë Fakultetit të Arteve të Bukura.

2. **Paga** – në këtë zë janë përfshirë:

- Shpenzimet për paga për punonjësit me kontratë (*personeli akademik i ftuar 18.804 orë*) për vitin akademik 2022-2023 si dhe personel me kontratë, kjo bazuar në VSA Nr.30 datë 20.07.2022, me vlerë 13.308.469 lek .
- Shtesa e pagës deri në kufirin maksimal, bazuar në VKM Nr.647 datë 05.10.2022. Vlera e kësaj shtese, për vitin 2023, është parashikuar të jetë 9.898.350 lek. Vlera mujore e shtesës është 1.319.780 lek për punonjësit mësimor.

3. **Sigurime shoqërore dhe shëndetësore** – në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për shpenzimet e parashikuara në zërin paga.

4. **Mallra dhe shërbime** – në këtë zë janë përfshirë:


- Bashkëfinancimi në vlerën 2.743.440 lek në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2022-2023 “Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit në Universitetin e Arteve”. Ky bashkëfinancim është bazuar duke marrë në konsideratë VBA Nr.20 date 28.12.2022.
- Pagesa e QNRA me vlerë 215.000 lek (*pagesa e plotë është 281.256 lek, diferenca është parashikuar të mbulohet nga granti i miratuar për vitin 2023 me VBA 1 datë 09.01.2023*)
- Materiale dhe shërbime me vlerë 400.000 lek për plotesimin nga ana infrastrukturore e Laboratorit të Tingullit pranë Fakultetit të Muzikës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. **Fond i pashpërndarë** – ky zë është krijuar për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara për vitin 2023, në rast të mosrealizimit të të ardhurave për vitin 2023.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur pesha specifike që zë cdo shpenzim në raport me shpenzimet totale (ku janë përfshirë edhe shpenzimet e miratuara me VBA Nr.3 dhe Nr.5 datë 16.02.2023), që parashikohen të realizohen për vitin 2023, me burim financimi të ardhurat e UART.



Për vitin 2022, me VBA Nr.2 datë 23.03.2022, u miratuan fonde për investime, me burim financimi të ardhurat e UART. Gjatë vitit 2022, megjithëse u realizuan procedurat e tenderimit, për disa investime nuk u arrit në prokurimin e tyre, mbasi nuk pati fitues. Referuar sa më sipër, kërkojmë rikonfirmim për vitin 2023, të investimeve të parealizuar gjatë vitit 2022, si në tabelën e mëposhtme:

Nr. llog.	Emertimi	Vlera (lek)
231	Pajisje teknike	11,099,576
231	Riparim piano	600,000
	TOTALI	11,699,576

Në vijim paraqiten shpjegimet për zërat e tabelës së mësipërme:

1. **Investime** – në këtë zë janë përfshirë blerje pajisje për mësimdhënie për plotësimin e laboratoreve në Fakultetin e Arteve të Bukura dhe Fakultetin e Artit Skenik në vlerën 8.771.870 lek. Gjithashtu janë përfshirë edhe blerje vegla pune në funksion të mësimdhënies për FAB, si dhe sektorin e mirëmbajtjes në UART me vlerë 2.327.706 lek.
2. **Riparim piano** – në këtë zë është përfshirë riparimi i pianos koncertale August Forster, e cila ka qenë në funksion të Sallës së Madhe.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Tabela Nr.1

Shpërndarja e të ardhura të UA për vitin 2023

Nr. llog.	Emertimi	Vlera (Lek)
231	Investime	2,030,000
600	Paga	23,206,819
601	Sigurime shoq & shëndet.	3,640,766
602	Mallra & shërbime	3,358,940
	Fond i pashpërndarë	2,419,519
	TOTALI	34,656,044

Tabela Nr.2

Rregjistri i prokurimeve, me burim financimi të ardhurat e UA, për vitin 2023.

Nr. Llog.	Emërtimi	Kap.6 (lek)
231	Pajisje teknike	11,099,576
231	Riparim piano	600,000
231	Kompjuter, printer,programe dhe të ngjashme	1,630,000
231	Libra	400,000
602	Blerje materiale për laboratorin e tingullit FM	400,000
	TOTALI	14,129,576

